**UDHËZIM**
**Nr. 24, datë 1.12.2023**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 3.4.2015, "PËR PËRMBAJTJEN DHE FORMËN E LICENCËS QË FITON KANDIDATI NË PËRFUNDIM TË PROVIMIT TË SHTETIT PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË RREGULLUAR TË MËSUESIT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; dhe të shkronjës "d", të pikës 8, të vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 3.4.2015, "Për përmbajtjen dhe formën e licencës që fiton kandidati në përfundim të provimit të shtetit për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit", të ndryshuar, të bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

a) Shkronja "k" e pikës 4, shfuqizohet;

b) Në shtojcën nr. 1, pas profilit me numër rendor 24, të shtohen profilet me numër rendor 25 dhe 26, si më poshtë:

"*25. Arte skenike, kodi 25;*

*26. Koreografi, kodi 26.".*

c) Shtojcat nr. 2 dhe nr. 3, të udhëzimit nr. 10, datë 3.4.2015, të ndryshuar, zëvendësohen me shtojcat me të njëjtin numër, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme për Arsimin Parauniversitar, njësitë arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
**Ogerta Manastirliu**

SHTOJCA NR. 2

| Nr. | Emri | Atësia | Mbiemri | Nr. ID (kartë identiteti/pasaportë) | ZVAP | Datëlindja | Vendlindja | Viti i diplomimit | Institucioni i arsimit të lartë | Fakulteti | Diploma "Bachelor" | Diploma "Master" | Profili | Hera |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | | | | |

SHTOJCA NR. 3


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
Qendra e Shërbimeve Arsimore
Licencë
PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË MËSUESIT NË PROFILIN
I lëshohet Z./Znj.
në zbatim të
ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pas përfundimit
të studimeve të ciklit të dytë Master
në
, kryerjes me
sukses të praktikës profesionale dhe kalimit në provimin e shtetit në datën
Drejtori i Përgjithshëm
Datë XX.XX.XXXX
Numri i licencës: XXXXXXXXX